REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY OF JUNIK

Kuvendi i Komunës
Nr. 002/07
Datë:02.02.2026

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika d) të Ligjit për vetëqeverisjen lokale (Ligji Nr.03/L-40, GZRK numër 28/2008), dhe në bashkërendim me udhëzimet administrative në fuqi, nenit 22 paragrafi 22.1 pika 4 të Statutit të Komunës së Junikut, Kuvendi i Komunës së Junikut në mbledhjen e tijë të rregullt të mbajtur më 02.02.2026 nxjerrë:

V E N D I M

Për inicimin e procedurave për plotësim dhe ndryshim të rregullores Komunale për menaxhimin e mbeturinave

I. Me këtë vendim miratohet inicimi i procedurave për plotësim dhe ndryshim të rregullores Komunale për menaxhimin e mbeturinave, propozuar nga Drejtoria për Shërbime Publike, Inspeksion, Mbrojtje dhe Shpëtim.

II. Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Kryetari i Komunës së Junikut, respektivisht Drejtoria për Shërbime Publike e Komunës së Junikut.

III. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyren protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetqeverisje Lokale,si dhe publikimit në gjuhën zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohen:

- Ministria e Pushtetit Lokal,
- Kryetari i Komunës së Junikut,
- Drejtoria për Shërbime Publike,
- Shërbimi i Kuvendit të Komunës së Junikut,
- Arkivi i Komunës së Junikut.

Kryesuesi i Kuvendit
z. Leonard Llolluni

2-155/498
20/01/2026

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

REFERENC-Ë:	Nr. I – 09/02/26
DATË/A:	20.01.2025
PËR/ZA/TO:	z.Leonard Llolluni – Kryesues i Kuvendit Komunal
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z.Ruzhdi Shehu – Kryetar i Komunës
NGA/OD/FROM:	z.Demokrat Ganijaj – U.D. Drejtor për Shërbime Publike, Inspeksion, Mbrojtje dhe Shpëtim
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë

I nderuar,

Bazuar në nenin 62 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, kërkojmë që të futet si pikë e rendit të ditës në mbledhjen e radhës të Kuvendit Komunal, fillimi i procedurave për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores Komunale për Menaxhimin e Mbeturinave.

Me respekt!